

**Dhënia e pëlqimit të kujdestarëve të fëmijëve (në vazhdim të quajtur si „prindër“) për dialogun e specializuar në mes të çerdhes së fëmijëve dhe shkollës lidhur me fëmijën**  
(Prindërit dhe shkolla e marrin nga një kopje të këtij pëlqimi)

Arsimimi, edukimi dhe kujdesi ndaj fëmijëve qëndron në radhë të parë në përgjegjësi të prindërve. Prindërit, çerdhja e fëmijëve dhe shkolla fillore janë partnerë në përgjegjësinë e përbashkët për fëmijën që do e nis shkollën. Miratimi i prindërve e mundëson një bashkëpunim mes partnerësh. si dhe një këmbim mendimesh të të gjithë pjesëmarrësve lidhur me fëmijën. Me forca të bashkuara arrihet shumë më mirë që fëmija të shoqërohet në mënyrë optimale me rastin e realizimit të detyrave që e presin me rastin e nisjes së shkollimit.

**(1) Pjesëmarrja e fëmijës në „kursin paraprak të mësimit të gjermanishtes para nisjes së shkollimit“ (të shlyhet, nëse nuk përkon)**

Për planifikimin e kursit është e domosdoshme të përpilohet një listë e të gjithë fëmijëve që do të marrin pjesë, listë kjo të cilën e merr edhe shkolla, dhe ku duhet të jenë të shënuara këto të dhëna: mbiemri, emri, data e lindjes dhe cilën/cilat gjuhë i flet fëmija në familje. Në kuadër të mbajtjes së kursit, që zhvillohet me ndarje të punës, punonjëse e specializuara pedagogjike të çerdhes dhe mësimit të shkollës fillore do t'i këmbëjnë rregullisht vëzhgimet e tyre lidhur me zhvillimet gjatë procesit mësues nga fëmija, si dhe do t'i këmbëjnë ato mes tyre me qëllim të përparimit optimal të fëmijës, si dhe zgjedhjes së masave të mëtejshme pedagogjike. Prindërit do jenë vazhdimisht të informuar lidhur me rrjedhën e zhvillimit të fëmijës së tyre.

**(2) Kalimi i fëmijës në shkollën fillore**

Ky kalim është për secilin fëmijë një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme në jetën e tij, por edhe në jetën e prindërve. Me nisjen e shkollës, për fëmijën fillojnë edhe kërkesat e reja, të cilat ai duhet t'i plotësojë brenda një kohe relativisht të shkurtër. Punonjësit e specializuar dhe mësimit të shkollës kanë për detyrë të përbashkët që ta përcjellin këtë fazë të ndjeshme, që t'i informojnë mirë fëmijët dhe prindërit lidhur me këtë kalim, si dhe t'u ndihmojnë atyre për ta mposhtur këtë kalim. Me rëndësi është që ky proces i realizimit të kalimit nga çerdhja në shkollë të kryhet bashkarisht, me qëllim që kalimi të ketë sukses. **Bisedat** lidhur me këtë, punonjësit e specializuar dhe mësimit të shkollës i zhvillojnë mundësisht në prani të fëmijëve, në mënyrë që kështu t'i marrin parasysh edhe njohuritë dhe përvojat e tyre, që i kanë për fëmijët.

**Në procedurën e nisjes së shkollimit**, për shkollën fillore (fjala vjen për personat kontaktues për bashkëpunim/drejtorinë e shkollës) mund të jetë i rëndësishëm këmbimi i mendimeve me entin e çerdhes së fëmijëve, sidomos për t'u këshilluar lidhur me atë, nëse fëmija ka nevojë për përkrahje të veçantë para, gjegjësisht pas hyrjes në shkollë (p.sh. ndihmë për të mbitalentuarit, ndihmë gjuhësore, vijimi i një klase për mësime gjuhe), ose nëse shtyrja e nisjes së shkollës ose ijimi i një shkolle me mësime shtesë do të ishte një vendim më i mirë. Në **vitin e 1-rë shkollor** mund të jetë me rëndësi për mësimit të shkollës e klasëve të para që t'i diskutojnë me punonjëset e specializuara të çerdhes së fëmijëve përshtypjet e tyre lidhur me fëmijën dhe sjelljen e tij me rastin e realizimit të fazës kalimtare, si dhe lidhur me propozimet e tyre përkitazi me shoqërimin optimal të fëmijës. Sfondi i përvijës, të cilën punonjëset e specializuara të çerdhes e kanë fituar gjatë shoqërimit intenziv dhe shumëvjeçar të fëmijës, mund t'i ndihmojë shkollës që ta kuptojë më mirë fëmijën, që të fitojë më shumë njohuri për anët e forta të fëmijës dhe të mësojë se si ta shoqërojë më mirë gjatë procesit të mësimit.

**Në raste, kur biseda të tilla duhet të zhvillohen, por edhe në raste kur duhet dorëzuar dokumente me shkrim, prindërit do të kontaktohen gjithnjë paraprakisht për t'i diskutuar me ta përmbajtjet konkrete** (fjala vjen kompetencat dhe anët e forta, gjendja dhe rrjedha e zhvillimit të fëmijës, masat e deritashme të ndihmës shtesë dhe nevoja për ndihmë të mëtejshme, lloji dhe mënyra e realizimit të kalimit) **si dhe pjesëmarrjen e tyre në biseda.** Para regjistrimit në shkollë, së bashku me prindërit plotësohet formulari i lëshuar nga ministritë përkatëse me titull „**Informatat në shkollën fillore**“.

**Në fund të vitit të 1-rë shkollor** përfundon shoqërimi i fëmijës në këtë fazë kalimtare. Shkolla fillore është e obliguar që ato dokumente dhe dosje shkollore, të cilat i ka përpiluar për fëmijën në kuadër të kooperimit me entin e çerdhes së fëmijëve, si dhe formularin e plotësuar „Informatat në shkollën fillore“ në këtë moment t'i shkatërrojë.

**Dhënia e pëlqimit nga ana i prindërve për këtë dialog të specializuar është vullnetar.** Nëse nuk jeni dakord me këtë procedurë, fëmija juaj nuk do të ketë disfavore. **Dhënia e pëlqimit mund të revokohet në çdo kohë.**

**Fëmija:** \_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri)

**Enti i çerdhes së fëmijëve:** \_\_\_\_\_

**Shkolla:** \_\_\_\_\_

(në rubrikë të shënohet emri, adresa dhe telefoni / emri i personit kontaktues për kooperim)

Me nënshkrimin tim jap **pëlqimin** që enti i çerdhes së fëmijëve dhe shkolla t'i këmbëjnë opinionet lidhur me fëmijën tim në kudin e lartcekur, nëse kjo është e nevojshme për realizimin e detyrave gjegjëse.

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_  
(vendi) (data) (nënshkrimi i kujdestarit/es të fëmijës)